

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE "Invision" Shpk**

Z. AHMET BERBERI, lindur me 13/04/1951, lindur ne Lis, dhe banues ne Tirane ,me dokument identifikimi karte identiteti nr ID F10413044F, i cili shprehu deshiren sipas kerkesave te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Shoqerite Tregtare" dhe Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007, "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" QKR, per krijimin e shoqerise me te dhenat e meposhteme :

NENI 1

Themeluesi me anen e ketij akti themelimi krijon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar te cilen do ta emertoje **Invision** Shpk, shoqeri e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe ne perputhje me dispozitat e statutit qe i bashkalidhet ketij akt themelimi.

NENI 2

Selia e Shoqerise do te jete ne Durres, ne adresen Kryesore Durres, Lagja nr. 4, Rruga Egnatia, ZK 8514. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine per nje periudhe **kohe te pakufizuar, mbi 10 vjet**, me te drejte perseritje per periudhen e metejshme, neqoftese ortaket bien dakort, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 3

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin ne fushen e Call Center, Tele-marketing. Per te gjithë aktivitetet per ushtrimin e te cilave **kerkohet license e posacme**, shoqeria do te ushtroje aktivitetin pasi me pare te jete pajisur me licensen perkatese nga organet kompetente.

NENI 4

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1000 LEKE (nje mije).Ky kapital eshte i perbere nga 1 kuote dhe ortaku i shoqerise zoteron 100% te kapitalit te shoqerise

NENI 5

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe do te marrin ortaket. Ne rast se kapitali i shoqerise per shkak te humbjeve te vertetuara ne dokumentat financiare rezulton me i vogel se gjysma e kapitalit themeltar, ortaket vendosin brenda tre muajve nga miratimi i llogarive te percaktojne kete humbje mbi mundesine e prishjes se parakoheshme te shoqerise. Ne rast se prishja nuk shpallet, shoqeria zvogelon kapitalin e saj me nje vlere jo me te vogel se ajo e humbjeve qe kane mbetur, pa mbuluar fondet rezerve.

NENI 6

Ortaket mund t'u shesin te treteve kuota te kapitalit te tyre, teresisht apo pjeserisht te shoqerise, te cilet kane te drejten e parablerjes qofte edhe ne kushte te barabarta. Kjo e drejte duhet ushtruar brenda 30 diteve nga data e komunikimit.

NENI 7

Organet drejtuese te shoqerise jane :

- Ortaket e shoqerise
- Administratori

Afati i emerimit te administratorit eshte 3 vjet, me te drejte riperseritje, ne baze te nenit 95 te Ligjit 9901, dt.14.04.2009, sic eshte percaktuar ne statut.

Procedura per emerimin ne funksionet perkatese dhe shkarkimin e tij rregullohen sipas statutit te shoqerise.



NENI 8

Administratori i shoqerise Z. Mario Berberi shtetas Shqiptar, lindur me 05.11.1977, lindur ne Burrel, Mat dhe banues ne Tirane, me dokument identifikimi karte identiteti nr. H71105059N. Dhe afati i tij ne shoqeri do te jete 3 vjet.

NENI 9

Vendimet e ortakeve mund te merren edhe nepermjet konsultimit me shkrim.

NENI 10.

Likujditet dhe transaksionet financiare do te depozitohen ne bankat shqiptare dhe ne ato te huaja, ku shoqeria ka llogaritet e saj rrjedhese. Per kapitalin themeltar te shoqerise eshte hapur libri i llogarive ku do te shenohet kontributi i ortakeve. Po keshtu shoqeria ka dhe perdor dokumentacionin sipas kerkesave te ligjit per kontabilitetin e gjithë kerkesave te tjera financiare te domosdoshme per veprimtarine normale te saj.

NENI 11

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria i mbeten ortakeve ne perpjestim me kontributin ne kapitalin themeltar te shoqerise, mbasi te jene likujduar te gjitha detyrimet, dhe te jene hequr 5 % qe do te futet ne fondin e rezerves ligjore deri ne permbushjen e 1/10 te kapitalit te shoqerise.

NENI 12

Shoqeria fillon veprimtarine e saj vetem pasi te kete marre autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit ne fuqi.

NENI 13

Ortaket jane te detyruar te ruajne karakterin sekret te dokumentacionit, te eksperiences se shkembyer, te realizuar brenda veprimtarise se shoqerise.

NENI 14

Te gjitha mosmarreshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, do te paraqiten per zgjidhje ne gjykatën kompetente shqiptare, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 15

Ky akt themelimi u perpilua ne prani te ortakeve duke shprehur ne te vullnetin e lire te tyre.

Ne Dt. 29/05/2020

Ortaku i Shoqerise

Invision SH.P.K,

Ahmet Berberi

Ahmet Berberi

